



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, ëeb: ëëë.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

Raporti teknik

Objekti: Shërbimi I Pastrimit , zona Qendrore.

Burimi I financimit:

Afati i realizimit: 12(dymbëdhjete) muaj

Vendodhja : Njësia Administrative Qendër

Gjendja aktuale:

Aktualisht shërbimi në zonën qendër ka dy kontrata, të ndara në zona "A" dhe zona " B", apo zona Veriore dhe ajo Jugore.

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve deri me tani ka përgjithsuar kryerjen e këtyre aktiviteteve:

- Organizimin ditor të shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve,
- Transportit dhe depozitimit të mbetjeve
- Fshirjen dhe lagjen e shesheve kryesore në qendër .
- Mirembajtjen e rrugeve gjate dites dhe te PGM.

Objektivi

Shërbimit të Pastrimit do ti shtohen aktivitetet si më poshtë:

- Organizimin më i detajuar ditor të shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve, duke vene ne perdorim edhe nje mjet 5 tonesh per evadim te mbetjeve ne rrugicat e ngushta.
- Klorifikimi I PGM dhe I kazaneve
- Larjen e rrugeve kryesore, pedonaleve.
- Rritja e siperfaqeve të rrugëve që do I shërbëhet , duke rritur përdorimin e teknologjise per fshirjen mekanike

Pra si objektiv kryesor kemi, përmisimin e cilësisë së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në zonën Qendër, nëpërmjet rritjes së performancës në mbledhjen, transportin dhe depozitimin e sigurt të mbetjeve në Landfill-in Bushat duke ju përshtatur "Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane" të miratuar.